



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E VUSHTRRIË

Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Datë:05/04/2019

**THIRRJE PËR APLIKIM
MAKINA PËR LAVRIM MOTO KULTIVATOR ME FREZË, FREZA PËR
TRAKTOR DHE PLLUGJ**

Komuna e Vushtrrisë gjegjësisht Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ka hapur fazën e aplikimit të projektit për Makina për lëvrim Moto Kultivator, freza, pllugj.

Ftohen të gjithë fermerët e interesuar që të aplikojnë për këtë projekt që ka për qëllim zhvillimin dhe përmirësimin e kushteve të kësaj veprimtarie.

Aplikuesit duhet t'i plotësojnë kushtet si në vijim;

- Të jenë banorë dhe fermer të Komunës së Vushtrrisë;
- Të kenë njohuri elementare në këtë lëmi;
- Participimi në rast përfitimi nga përfituesit e makinës së kërkuar është 20% nga vlera e pajisjes së kërkuar ; Moto kultivator me frezë, Frezë apo Pllugj.

Dokumentet për aplikim:

- Aplikacioni.
- Kopja e letërnjoftimit të aplikuesit;
- Vërtetimin që dëshmon se i keni kryer obligimet komunale (Vërtetimin e tatimit në pronë, Vërtetimin e mbeturinave)
- Fletën poseduese të tokës
- Bashkësinë familjare (Çertifikatën familjare)

Aplikohet në zyrën pritëse të komunës;

Afati i fundit për aplikim:23/04/2019 ora 15:00

Vërejtje: Gjatë procedurës së kontrollit, në rast të gjetjes së shkeljeve dhe tentimit për mashtrim do të aplikohen masa ndëshkimore duke mos i dhënë mundësi përfitimi për tre vitet e ardhshme.

Dorëzimi i dokumentacionit pas përfundimit të afatit të publikuar, nuk do të pranohen për shqyrtim.